LIGJ
Nr. 35/2021

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 115/2017, "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Në ligjin nr. 115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8, shkronjat "b" dhe "ç" riformulohen si më poshtë:

"b) miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm administrativ, fushën e kompetencave dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave të brendshme, përshkrimin e punës së stafit administrativ e mbështetës të Agjencisë, si dhe miraton rregulloren për mënyrën e funksionimit dhe procedurat e vendimmarrjes së Këshillit Drejtues;

ç) shqyrton dhe propozon strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë dhe ia dërgon për miratim dhe procedim të mëtejshëm ministrit përgjegjës për diasporën sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 4, të ligjit.

Neni 2

Pas nenit 10 shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 10/1
Prokurime të veçanta të Agjencisë

Prokurimi i blerjeve të punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve, të cilat nevojiten të kryhen me qëllim zbatimin dhe realizimin e programit vjetor të Agjencisë, përfshirë dhe pa u kufizuar në marrjen me qira të ambienteve dhe/ose pajisjeve dhe mallrave, lidhjen e kontratave të veçanta me bashkëpunëtorë të jashtëm ose figura të njohura shqiptare në diasporë, prokurimin e elementeve specifike të nevojshme në kuadër të zbatimit të detyrimeve të përcaktuara përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale për organizimin e aktiviteteve, blerjen dhe/ose shpërndarjen e dhuratave të destinuara për aktivitete që zhvillohen brenda dhe jashtë vendit, por që nuk rregullohen nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, kryhen sipas rregullave të përgjithshme, kritereve dhe procedurave specifike të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Në nenin 13, pika 1, pas togfjalëshit "Autoritetet shtetërore" shtohet togfjalëshi "dhe njësitë e qeverisjes vendore".

Neni 4

Në nenin 16, pika 1, pas fjalëve “pika 5” shtohet numri i nenit “10/1”.

Neni 5
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë vendimin sipas përcaktimeve të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.3.2021.